



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORI

Nr. 1098 Prot.

Vlorë më, 30.06 .2021

URDHËR

NR. 50 , DATË 30.06 .2021

"MBI MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË RISHIKUAR NË UV"

Në zbatim të nenit 5, të Ligjit nr.119/ 2014, "Për të drejtën e informimit", të Urdhrit nr.137, datë 18.12.2020, "Për miratimin e Programit të Transparencës së Rishikuar në UV", të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe të neneve 4 pika 1, 33 dhe 34 të Statutit të UV-së,

MIRATOJ:

1. Programin e transparencës së Universitetit të "Ismail Qemali" Vlorë , të rishikuar, në kuadër të detyrimeve që vijnë nga ligji për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
2. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Koordinatori për të drejtën e informimit në UV.
3. Këtij urdhëri i bashkangjitet Programi i Transparencës së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, i rishikuar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



PROGRAMI I TRANSPARENCËS

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" (në vijim "LDI"), Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë (në vijim "UV") duhet të publikojë Programin e Transparencës (në vijim "PT") të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhërave Personale (në vijim "Komisioneri"). AP duhet të publikoj informacionin sipas veprimtarisë së tij funksionale si dhe të rishikoj e përditësoj PT në çdo rast të ndryshimit tëb aktivitetit institucional, kuadrit ligjor rregullator apo çdo elementi tjetër (që ka lidhje me transparencën proaktive).

Në PT janë të specifikuara kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publik. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jete: i plotë, i saktë, i përditësuar, i thjeshtë në konsultim, i kuptueshëm, lehtësisht i aksesueshëm dhe i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të UV. Gjithashtu, përpara publikimit të informacionit UV duhet të vlerësojë nëse ka ndonjë kufizim ligjor për publikim.

Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtëpërdrejtë për ta.

Behen publike me anë te afishimit apo postimit në faqien zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga UV.

Në programin e transparencës janë të specifikuara kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publik, mënyra e publikimit, si dhe parashikimet ligjore prej të cilave lind detyrimi për publikim. Në publikimin e informacionit, AP duhet të mbajnë parasysh interesin e publikut si dhe të mundësojnë aksesimin lehtësisht në informacionin publik.